




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



N.T.P. "Ardi"  
Numri i biznesit 80198582  
Pronar – Ymer KURTOLLI  
NTP ARDI  
Podujevë



#### VENDIM

për ndërprerjen e licencës të Operatorit të Shpërndarjes NTP ARDI, me seli në Podujevë

#### Faktet


1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. NTP ARDI është operator i shpërndarjes i licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për shpërndarjen e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale përmes rrjetit kabllorë, në pajtim me Rregulloren KPM-2016/01, me seli në Podujevë. KPM, me datën 26 shkurt 2015, ka marr vendim për dhënien e licencës për operatorin e shpërndarjes NTP ARDI.
3. Më datën 11 dhjetor 2019, pronari i operatorit të shpërndarjes NTP ARDI, përmes një shkrese të dorëzuar në KPM me anë të e-mailit, ka njoftuar se heq dorë nga licenca e operatorit të shpërndarjes.

#### Arsyetimi

4. Duke marrë parasysh njoftimin e pronarit të operatorit të shpërndarjes NTP ARDI, për heqje dorë në mënyrë vullnetare nga licenca, Komisioni konstaton se ka bazë të mjaftueshme për ndërprerjen e licencës së NTP ARDI.

## Vendim

5. Komisioni në takimin e tij, të mbajtur më datë 31 janar 2020, merr vendim për ndërprerjen e licencës së operatorit të shpërndarjes NTP ARDI, në bazë të njoftimit për heqje dorë në mënyrë vullnetare nga Licenca e KPM-së.
6. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.



Muja FERATI

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



04.02.2020

datë